



RELACIONI ARKITEKTONIK

OBJEKTI:

"RIKONSTRUKSION I KOPSHITIT TE FEMIJEVE, FUSHE ARREZ"

- MARS 2022 -



HYRJE

Ky dokument tē konsiderohet si pjesë përbërëse e Dokumentacionit të Projekti Zbatimit dhe Preventivit Përfundimtar për objektin e mësipërm që së i tillë duhet tē lexohet së bashku me vizatimet teknike dhe detajet e projektit.

Detyrat e këtij Raporti janë:

- Të evidentojë problematikat ndërtimore në Objektet që janë në studim, ne kuadër të qëllimit të shprehur në Detyrën e projektimit
- Të shpjegojë qasjen për zgjdhjen e këtyre problematikave.
- Të shpjegojë me fjalë zgjdhjen

Të përgjithshme

Bashkia e Fushe Arrezit kërkon tē realizojë projektin e rikonstruksionit për objektin: "Rikonstrukcion i Kopshtit te femijeve, Fushe Arrez", Njësia Administrative Fushe Arrez, në qytetin e Fushe Arrezit. Kjo godinë është ndërtuar para viteve 90 dhe megjithëse janë kryer riparime të pieszshme në vitet e fundit, vihen re probleme të cilat kërkojnë ndërryje sa më të shpejtë për t'ri eliminuar dhe për të shmangur degradimin e metejshem.

Qëllimi

Qëllimi i këtij projekti është propozimi i ndërrhyrjeve ndërtimore në objektin ekzistues duke marrë parasysh perspektivën 10 vjeçare të rrithjes së numërit të fëmijëve.

Objektivat

Objektivat që grupi projektues kërkon tē realizojë në përfundim tē projektit "Rikonstrukcion i Kopshtit te femijeve, Fushe Arrez" janë:

- Rikonstrukcion i godinës ekzistuese (rifiniturat e jashtme dhe tē brendëshme, zëvendësim dyersh etj.)
- Elementim i barrierave arkitektonike (për personat me aftësi të kufizuar) në hyrje të objektit, në qarkullimin vertikal si dhe në përdorimin e plotë të ndërtesës.
- Riorganizim të ambienteve të jashtme dhe terreneve sportive në oborrin e jashtëm.
- Rikonstrukcion të nyjeve sanitare.
- Rikonstrukcion i mbusesës (Ndërtim çati e vendi).
- Vendosje të sistemit të ngrohjes.
- Instalime të reja elektrike, telefonike dhe rrjeti interneti.


TE DHENA TE PROJEKTIT

Vendndodhja

Kopshti i femijeve ne qytetin e Fsuhe Arrexit ndodhet ne qender te qytetit, prane Qendres Kulturore te Femijeve. Kopshti ne Veri kufizohet me shkallet qe ngjitesh ne lagje, te cilat sherbejne dhe per te aksesuar kopshtin nga rruga kryesore. Ne Lindje ka oborrin dhe skarpaten para oborrit e cila perfundon me nje mur mbajtes. Ne Perendim kufizohet me nje mur mbajtes dhe sheshin e banesave kolektive. Ne Jug kufizohet me nje banese dykateshe, prone private.

Koordinatat e shkolles sipas WGS84 jane:

42.07000684258407, 20.032796452216107
42.0700223263249, 20.032631928206232
42.06977502518981, 20.032581539376313
42.06975289096687, 20.032723555007436



Gjurma e siperfaqes se ndertimit eshte **338 m²**.

Siperfaqja e sheshit te ndertimit eshte **1276 m²**.

GJENDJES EKZISTUESE TE KOPSHTIT

Përshkrimi i projektit


Punimet e parashikuara sipas specifikkimeve teknike:

- Rikonstrukcion i rifiniturës së brendëshme dhe të jashtme;
- Rikonstruksion i nyjeve sanitare;
- Punime në sistemimin e jashtëm;

Projekti i rikonstrukcionit propozon një ndërhyrje në këto nivele:

Ndërhyrje në interier

- Parashikohet të prishen shtrimet ekzistuese me pllaka dhe të zëvendësohen me pllaka porcelanati.
- Nëpër klasa dhe zyra, suvatimet e mureve dhe tavanëve parashikohet të prishen dhe ribëhen.



- Nëpër korridore do të suvatohen tavanet dhe do të lyhen me ngjyrë të bardhë.
- Dyert ekzistuese do të hiqen dhe do të zëvendësohen me dyer druri importi të cilësisë së parë.
- Pragjet e dyerve do të jenë prej material mermeli me spesor 2cm.

Nyjet sanitare

- projekti parashikon rikonstruksion të nyjeve sanitare.
- Një përbledhje e punimeve:
- Secili grup i femijeve do te kete hyrjen dhe nyjet sanitare te saj.
 - Hegje të plakave të shtrimit dhe veshjes së mureve.
 - Prishje suvatime ekzistuese
 - Prishje muresh ekzistuese
 - Ndërtim i mureve të reja
 - Hidroizolime
 - Veshje dhe shtrim me plaka të reja.

B- Ndërhyrjet në eksterier

- Në të gjithë fasadën do të kemi veshje me sistem kapote.
- Veshja e xokolaturës do të bëhet me travertinë ngjyrë bezhë.
- Dritaret ekzistuese do të hiqen dhe do të zëvendësohen me Dritare duroalumini me xham të dyfishtë.
- Ne pjesen e shkolles se mesme do te krijohet hyrje nga fasada ballore.
- Ne klasen e kopshit do te krijohet një hyrje e vecante.

Mbulesa (çatia)



për qëllime të përmirësimit të termoizolimit dha hidroizolimit, parashikohet që mbi taracën ekzistuese të ndërtohet një mbulesë tip me Çati venditë zakonshme HD~8m, mbuluar me tjegulla marsejeze me ngjyrë të kuqe. Ufuzet do të jenë prej llamarine të xinguar të lyera me bojë ngjyrë kafe me pikje me kod të ngjyrës.



Elementimi i barrierave arkitektonike

Projektuesi, për të mundësuar përdorimin e plotë të ndërtesës nga Personat me aftësi të kufizuar (PAK), ka parashikuar vendosjen e dy rampave me pjerësi $1=5\%$ në hyrje të objektit.

Nderhyrje te nevojshme :

- Objekti do të suvatohet nga brenda ne mure ne te gjitha sipërfaqet perkatese duke ruajtur shtresan e pare ekzistuese.
- Muret e brendshem do te lyhen me boje hidromat, pjesa e poshtme e tyre do lyhet me boje akrilik me ngjyra të ndryshme ose jo nga muret, gjë e cila do te vendoset ne bashkepunim me stafin drejtues te kopshit.
- Dyert e brendshme te shkolles do te ndrrohen te gjitha dhe do te jene dyer druri te cilesise se para.Lartesia e dyrve do te rritet dhe do te krijohet një arkitra tulle per realizimin e kesaj. Hapja e dyerve do te jetë nga fashtë qe te plotesoje kushtet e evakuimit ne raste emergjencash. Dritaret do te nderrohen. Do te zevendesohen me Dritare duralumini te cilesise se larte me hapje me rrotullim dopio-xham.
- Dritaret e kateve te para do te jene dhe me kangiella metalike sipas projektit per te permbyshur normat e sigurisse.
- Nderhyrja per riparimin e tarraces do te realizohet me cati me tjequlla vendi. Do te krijohet një brez betoni ne perimter te godines per te krijuar kapjen e trareve te catise.
- Fasada do te vishet me poliesterol kompakt jeshil $t=5\text{cm}$ + rjete + suva (KAPOTE)
- Ne oborrin e jashtem do te instalohen kënde lojrashe per femije dhe ambiente te gjelberta.








Forma perfundimatre e objektit:

Pas nderhyrries per rikonstruksionin objekti do te kete nje fasade teresisht te re, me termoizolim. Gjithashtu ambientet e jashtme do te jene totalisht te sistemuara.





"TRIANGLE" sh.p.k
Drejtues Teknik
Ing. Zenulla MEHMETI



